

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-tetor 2020

Zhvillime të tjera

- AMF nxjerr për konsultim publik projektregullore për tregjet nën mbikëqyrje
- Organizatat ndërkombëtare të mbikëqyrësve ku aderon edhe AMF zhvillojnë mbledhjet vjetore

Publikime Profesionale

- EIOPA publikon “Panelin e Riskut” të përditësuar me të dhëna të gjysmës së parë 2020
- OECD publikon “Vështrim mbi tregun e pensioneve”
- Global Risk Regulator Monedhat digjitale përfaqësojnë dilema të stabilitetit financiar për bankat qendrore
Autoritetet rregullatore të tregjeve të kapitalit po përdorin gjithnjë e më shumë teknologjinë për t’i dhënë kuptim të dhënave
- XPRIMM Raporti mbi tregun e sigurimeve – Gjashtëmuji 2020
Raporti mbi sigurimin motorik – Viti 2019 dhe gjashtëmuji 2020

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Greqi
- Kroaci
- Mali i Zi
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-tetor 2020

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-tetor 2020 arritën vlerën 13,513 milionë lekë, ose 5.43% më pak se në periudhën janar-tetor 2019. Gjatë periudhës janar-tetor 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 785,393 me një ulje prej 28.93% krahasuar me periudhën janar-tetor 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.18% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 6.81%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.90% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.10% të totalit të tregut.


Gjatë periudhës janar-tetor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,192 milionë lekë, ose 23% më shumë se në periudhën janar-tetor 2019.



Gjatë janar-tetor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,192 milionë lekë, ose 23% më shumë se në periudhën janar-tetor 2019.



Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Tetor 2020



Projektregullore

Faqe Kryesore - Legjislacioni - Projektakte - Projektregullore

Projektregullore "Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve në Republikën e Shqipërisë"

VERIFIKONI POLICËN TUAJ

Projektregullore "Për formën dhe procedurën e regjistrimit të akt-ofertës për emetimin e obligacioneve"

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

Projektregullore "Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve"

Projektregullore "Për formatin e pyetësorit të vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit"

Projektregullore "Për procedurën e certifikimit dhe kualifikimet e punonjësve me funksione kyçe të shoqërisë komisionere"

Projektregullore "Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere"

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Rruga "Dora D'Amia", Nr.10, P.O. Box 8363, Tirane, Shqipëri

+355-(0)-4-2257560, 08006969

+355-(0)-4-2250686

amf@amf.gov.al

www.amf.gov.al

E Hënë - E enjte 08:00 - 16:30

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", ka hartuar projektregulloren "**Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve në Republikën e Shqipërisë**". Projektregullorja gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=57>

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren "**Për formën dhe procedurën e regjistrimit të akt-ofertës për emetimin e obligacioneve**". Projektregullorja gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=55>

Mbledhja Vjetore e IOSCO-s diskuton ndikimin e COVID-19 në tregjet e kapitalit

Anëtarët e IOSCO-s (International Organization of Securities Commissions) zhvilluan *online* Mbledhjen e 45-të Vjetore. Mbledhja e cila u zhvillua në datat 9-18 nëntor, përfshiu edhe takimet të tjera si Mbledhje e Bordit të IOSCO-s, Mbledhjen e Komitetit GEM (Growth and Emerging Markets), mbledhjet e katër Komiteteve Rajonale, etj. Në mbledhje u diskutua progresi i bërë në drejtimet prioritare të punës së IOSCO-s si rreziqet e stabilitetit financiar, fragmentarizimi i tregut, sjella në treg, teknologjia e informacionit në shërbim të tregjeve financiare, etj.


Takimi u përmyll me bashkëbisedimet virtuale të anëtarëve të IOSCO-s me Presidentin e Komitetit duke lejuar kështu që anëtarësia të përfshihet në diskutime me drejtuesit e IOSCO-s në çështje si financat e qëndrueshme, fragmentimi i tregut dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 që po i riformaton tregjet e kapitalit. Bordi i IOSCO-s miratoi dy tema të tjera prioritare për vitin 2021: (i) Stabiliteti financiar dhe risqet sistemike në institucionet financiare jobankare; dhe (ii) Puna në distancë, rreziqet e sjelljes joetike në biznes, skemat mashtruese, fleksibiliteti operacional në kuadrin e pandemisë COVID-19.

IAIS përfundon mbledhjen e përgjithshme Vjetore dhe përcakton katër prioritete për vitet në vijim

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (The International Association of Insurance Supervisors, IAIS) përfundoi Konferencën Vjetore të 27-të si edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore dhe mbledhjet e disa prej komiteteve. Të gjitha këto takime u zhvilluan në formatin virtual duke pasur pjesëmërrje të gjerë të anëtarëve dhe të ftuarve të tjerë. Në takime u finalizuan mjaft projekte dhe u diskutua edhe për situatën dhe ndikimin e COVID-19 në sektorin e sigurimeve në nivel botëror, duke përcaktuar edhe drejtimet për vitin 2021.

Komiteti Ekzekutiv përcaktoi edhe katër prioritetet për vitet në vijim:

1. Vlerësimi i rreziqeve dhe ruajtja e stabilitetit financiar, duke përfshirë vlerësimin e pikave më të dobëta që lindin si pasojë e COVID-19;
2. Përcaktimi i pikave kyçe pas krizës, duke përfshirë monitorimin për një periudhë 5-vjeçare;
3. Adresimi i rreziqeve dhe mundësive të tendencave kyçe, sidomos atyre që dolën më shumë në pah nga pandemia COVID-19. Diversiteti, përfshirja financiare si edhe ndihma për tregjet e reja në zhvillim për të kaluar në mbikëqyrjen me bazë rreziku do të ketë një vëmendje të shtuar në punën e IAIS;
4. Mbështetja e mbikëqyrësve të sigurimeve nga vendet anëtare të IAIS në zbatimin dhe vlerësimin e mëtejshëm të standardeve ndërkombëtare që ka përcaktuar IAIS.



Siguruesit evropianë janë më pak të ekspozuar ndaj rreziqeve krahasuar me fillimin e shpërthimit të pandemisë COVID-19, por shqetësimet mbeten sërish

<https://www.eiopa.europa.eu>

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) publikoi Panelin e Riskut të përditësuar bazuar në të dhënat e tremujorit të dytë të vitit 2020 lidhur me Solvency II.

Rezultatet tregojnë se ekspozimet ndaj rrezikut për sektorin e sigurimeve të Bashkimit Evropian u ulën pak, krahasuar me vlerësimin e rrezikut të korrikut. Siguruesit janë veçanërisht të ekspozuar ndaj niveleve shumë të larta të rrezikut makro, ndërsa rreziqet e tregut, kredisë, përfitimit dhe aftësisë paguese u ulën në nivelin mesatar. Sidoqoftë, vlerësimi i rrezikut nuk llogaritet shpërthimin e valës së dytë të pandemisë.



OECD – Vështrim mbi tregun e pensioneve

<https://www.iosco.org/>

OECD publikoi raportin "*Pension Markets in Fokus*". Raporti përshkruan zhvillimet deri në fund të vitit 2019 duke nënvizuar zhvillimet në sektorin e pensioneve në mbarë botën. Nëpërmjet një seksioni të veçantë në këtë botim bëhet një parashikim i zhvillimit të aseteve të pensioneve përgjatë 2020, në kohën e shpërthimit të pandemisë COVID-19. Raporti i përvitshëm "*Pension Markets in Fokus*" jep një përmbledhje të sistemeve private të pensioneve në të gjithë botën dhe përshkruan zhvillimet më të fundit në 87 vende.



CAPITAL

Digital currencies pose financial stability dilemma for central banks

Monedhat digjitale përfaqësojnë dilema të stabilitetit financiar për bankat qendrore

<https://www.globalriskregulator.com/>

Monedhat digjitale janë një kufi i ri, i guximshëm për bankat qendrore dhe mund të japin shumë përfitime për ekonominë, por ekzistojnë gjithashtu shqetësime që duhet të adresohen përpara se ato të përdoren gjerësisht në sistemin financiar.

Global Risk Regulator
A PUBLICATION FROM THE BANKER
October 2020 | Volume 18, Issue 9

Contents

- UK's financial services ambitions could boost City of London
- Banks gear up for tougher stress tests
- Mixed evidence on green bonds accelerating transition to low carbon economy
- Newsrooms (11-15)
- Antitrust considerations delay ISDA launch of ISOR fallbacks documentation; Banks face more fines following FinCEN money laundering rebellion; ESMA recognises three UK clearing houses; Basel Committee ready to pursue more Covid-related measures if needed; European banks face slow recovery from Covid-19 as ECLs weigh; Capital requirements will eventually be influenced by climate stress tests; and more...
- Whistleblowing seen by regulators as important for stopping misconduct
- Regulators turn to technology to make better sense of data
- US regulatory round-up
- Sentiment suggestions to quickly boost Australian fintech prove controversial
- Banks can't rest on laurels over operational resilience

Growing EU-UK financial services rivalry driving divergence
The EU is making revisions to its regulatory framework suggesting that it wants to deregulate to take on the UK in financial services, a move which could see the two jurisdictions quickly diverge on their rulebooks. *By Justin Fugleley*

Some see a degree of irony in the prospect of the EU's financial regulatory regime diverging from the UK's as it pursues a deregulatory approach in a bid to grab financial services business from the City of London. After the UK voted to leave the EU on June 23, 2016, it was the EU which expressed grave concerns that the UK could transform itself into a dangerously deregulated financial centre, boosted by competitive tax policies. However, the European Commission has announced it is pursuing significant revisions to rules on the Markets in Financial Instruments Directive II (MiFID II) going beyond those announced by the UK, meaning it is so far staying closer to the original rules. This sets the scene for divergence between the two from next year onwards. It also adds to the complex array of factors influencing to page 2

Banks can weather the pandemic storm
The post-pandemic landscape for lenders is murky and hard to predict, say analysts, but a well capitalised banking system and continued government support provides a degree of reassurance. *By Farah Khalique*

Lenders on both sides of the pond have granted extensive forbearance towards borrowers under financial stress, as a result of the coronavirus pandemic. Mortgage holidays have been rolled out in both the US and Europe, as banks grapple with supporting customers in unprecedented times. However, some of these support measures are set to wind down, plus it looks unlikely we're going to get the fabled, much-hoped-for V-shaped economic recovery. In what kind of state are US and EU banks likely to emerge post-pandemic?

A drawn-out recovery
Global GDP plunged 10% in the first half of the year as country-wide lockdowns ravaged economies, prompting world leaders to intervene

with large-scale measures and cut regulatory requirements for banks. Meanwhile, the hope was to keep the virus into submission and spark a "V-shaped" economic recovery. Neither has happened. The US is still fumbling its way through the first wave of the virus, while Europe's largest economies are now battling a second. A V-shaped recovery at this point is unlikely and we do not appear to be moving towards a U- or L-shaped economic recovery either, says Priy de Silva, senior corporate credit research analyst at Aware Asset Management. "The economy started improving" to page 7


globalriskregulator.com
A publication from the Financial Times

Global Risk Regulator – Autoritetet rregullatore të tregjeve të kapitalit po përdorin gjithnjë e më shumë teknologjinë për t'i dhënë kuptim të dhënave

<https://www.globalriskregulator.com/>

Teknologjia po u jep mundësi mbikëqyrësve të tregjeve të kapitalit të kuptojnë më shumë se çfarë po ndodh në këto tregje. Megjithatë, atyre u mbetet një rrugë e gjatë për të bërë përpara se të arrijnë të shfrytëzojnë këto kapacitete. Teknologjia po u jep mundësi rregullatorëve për më shumë transparencë, megjithatë një pjesë e mirë e të dhënave shpërdorohet. Kjo do të thotë se mbetet ende punë deri në arrijten e shfrytëzimit të të gjitha të dhënave në funksion të mbikëqyrjes.

XPRIMM publikon dy botime mbi tregun e sigurimeve për vendet e Europës dhe Azisë



XPRIMM INSURANCE Report jep të dhëna për tregun e sigurimeve gjatë gjysmës së parë të vitit 2020.

Informacioni është i ndarë për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, vendet e Evropës Juglindore si edhe vendet e Commonwealth të vendeve të pavaruara (CIS).



XPRIMM MOTOR INSURANCE Report jep të dhëna për tregun e sigurimit motorik përgjatë gjithë vitit 2019 si edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2020.

Informacioni është i ndarë për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, vendet e Evropës Juglindore si edhe vendet e Commonwealth të vendeve të pavarura (CIS).

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Agjencia e Sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës, AZOBiH, raporton se për periudhën janar-shtator 2020 siguruesit boshnjakë raportuan një total prej 569.13 milionë BAM (rreth 291 milionë EUR).

Pjesën më të madhe të tregut e zënë sigurimet e Jo-Jetës me rreth 80.29% të tregut duke arritur në 233.64 milionë EUR, ndërsa sigurimi i Jetës kontribuoi me pjesën e mbetur duke arritur në 57.35 milionë EUR.

Shoqëritë e sigurimit në Federatën e Bosnje-Hercegovinës siguruan rreth 70% të primeve të shkruara bruto, duke regjistruar një dinamikë më mirë të konsoliduar sesa siguruesit në Republikën Serbe të Bosnjës.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimeve, HAIC, për periudhën janar-shtator 2020 tregu i sigurimeve realizoi një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 2.87 miliardë euro, me një rënie prej 4.5% në terma vjetorë.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me vetëm 0.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.55 miliardë euro. Ndërsa linja e biznesit të sigurimeve të Jetës pësoi një rënie me rreth 10% duke arritur në 1.31 miliardë euro. Në këto shifra ka ndikuar mjaft dinamika negative e raportuar për policat tradicionale të sigurimit të Jetës (me rënie prej 16.8%).

Shifrat e tregut të botuara nga HAIC përfshijnë shifrat për 51 kompani sigurimesh, nga të cilat 19 operojnë në sigurimin e Jetës dhe 43 në sigurimet e Jo-Jetës.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të botuara nga Byroja Kroate e Sigurimeve (*Croatian Insurance Bureau, CIB*) vëllimi i primeve të shkruara bruto në fund të shtatorit 2020 për siguruesit kroatë pësoi rënie me 1.43% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 8.042 miliardë HRK. E shprehur në euro primet arritën në 1.07 miliardë EUR.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës u rrit me 4.25% duke arritur në 6.04 miliardë HRK, ndërsa në sigurimet e Jetës u realizuan 2 miliardë HRK prime.

Dëmet e paguara bruto nga siguruesit kroatë patën një rritje dyshifrore me 12,18% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja ishte kryesisht në klasat e sigurimit të pronave, të cilët patën një rritje prej 38% krahasuar me periudhën janar-shtator 2019. Kjo rritje gjykohet të jetë ndikuar nga tërmeti që goditi Zagrebin këtë vit.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Duke iu referuar të dhënave tremujore të tregut të sigurimeve të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, (*ISA*), në fund të shtatorit 2020, tregu i sigurimeve në Malin e Zi arriti në 71.63 milionë EUR, ose 0.97% më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Për 9 mujorin e vitit 2020, vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jo-Jetës u ul me 5.53% duke arritur në 57.24 milionë EUR, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 22.58% duke arritur në 14.38 milionë EUR.

Gjatë periudhës janar-shtator 2020 siguruesit malazezë paguan dëme me vlerë 25.24 milionë EUR, ose 2.55% më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019. 5.16 milionë EUR dëmshpërblime u paguan për tregun e sigurimit të Jetës dhe 20.07 milionë EUR në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës.

TURQI

www.xprimm.com

Në fund të shtatorit 2020, sipas shifrave të tremujorit të botuara nga Shoqata e Kompanive të Sigurimeve dhe Risigurimeve të Turqisë tregu lokal i sigurimeve u rrit me 22.4% krahasuar me periudhën janar–shtator 2019, duke arritur TRY 59.3 miliardë ose 6.5 miliardë Euro. E shprehur në monedhën evropiane, për shkak të diferencave të kursit të këmbimit (1 EUR = 9.10 TRY në 30 shtator 2020 kundrejt 1 EUR = 6.17 TRY në 30 shtator 2019), ndryshimi i tregut ishte negativ, pra me rënie prej 16.9%.

Primet e sigurimit të Jetës u rritën me 52% për nëntëmujorin 2020 krahasuar me nëntëmujorin 2019, duke arritur në TRY 11.25 miliardë. Ndërsa primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 17% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në TRY 48 miliardë.

Në fund të shtatorit 2020, grupet e sigurimeve që kishin rritjen më të madhe të primeve të shkruara bruto ishin: MTPL (24.86%), Jeta (18.98%), zjarri dhe rreziqet shtesë (12.29%) dhe shëndeti (12.24%).



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al